

The background is a solid teal color. It features two sets of three wavy, horizontal lines in a slightly darker shade of teal. One set of lines is positioned in the upper half of the page, and the other set is in the lower half, framing the central text.

PSIKOLGJIA

Një kuadër referues:

HISTORIA

Fillimisht psikologjia ishte pjesë e filozofise, nga e cila shkëputet vetëm në fillim të shekullit të XIX. Ajo gjen një statut të parë shkencor brenda kulturës gjermane, shprehje e përpjekjes për të trajtuar dukuritë psikike sipas një metode që mund të përkufizohet shkencore, pra sipas paradigmës që i takon shkencës “pozitive”. Objekt i hulumtimit të saj është pra ndërgjegjja, shpirti, dimension i psikik, metoda, kërkimi i ligjeve që qeverisin këtë aspekt të qenies njerëzore.

Në fund të shekullit ky impostim vihet në diskutim nga lindja e *psikanalizës* që kërkon të dallohet nga ajo që nga ai çast e më tej do të quhet psikologjia shkencore (apo eksperimentale). Karakteristikë e psikanalizës dhe e degëzimeve të ndryshme që do të krijohen është mbajtja e njeriut në qendër të reflektimit të saj si subjekt specifik dhe aktiv. Për këtë arsye zhvillimi i *psikologjisë shkencore*, e shtyre nga nevoja e një përkufizimi gjithnjë e më të sakte në planin metodologjik dhe konstatimi i kompleksitetit të objektit të hulumtimit, të njeriut, do të tentojë të përqendrojë reflektimin e vet mbi objekte me specifike dhe të vecanta. Zhvillimi i psikologjisë shkencore do të karakterizohet nga një ndryshim gjithnjë e më të gjere të objektit të hulumtimit të cilit i korrispondon edhe një ndryshim i gjere në planin metodologjik. Këto dy drejtime reflektimi, psikanalitik dhe shkencor, do të vazhdojnë të ndërthuren mes tyre (ndonëse shumë shpesh duke u ndeshur) duke mundur në këtë mënyrë arritjen e objektivave mjaft të rëndësishëm njohës.

Për këtë arsye termi ‘psikologji’ do të përmbajë në vetvete objekte studimi dhe impostime metodologjike që qëndrojnë nga lëmi i shkencave njerëzore në atë të shkencave bi-

ologjike, prandaj dhe njohuritë që do të prodhohen prej saj, gjithnjë e më dukshëm, do të duhet të konsiderohen më saktë si ‘materiale’ dhe/ose ‘mjete’ sesa si ‘udhërrëfyes’ të punës edukuese.

Zhvillimi dhe të nxëniti

Janë dy termat që shfaqen gjatë reflektimit që shoqëron udhën e psikologjisë: zhvillimi dhe të nxëniti. Ato u referohen dy karakteristikave që e shënojnë njeriun atë sa e dallojnë atë nga çdo gjallesë tjetër. Të dy i referohen faktit se njeriu karakterizohet si individ për ‘hapjen’ e tij ndaj kontekstit në të cilin jeton. Çdo njeri duket të shënohet kështu nga një ‘histori vetjake’ njohja e të cilës është thelbësore për të kuptuar atë çka ai vetë është. Kërkimi i një shpjegimi për sjelljen prej të rrituri zhvendoset për këtë arsye nga studimi i njeriut të rritur në studimin e fazave që e përgatisin atë e ku shfaqet qartë ndryshimi i vazhduar (rritja/zhvillimi).

Për të njohur/shpjeguar njeriun duhet të njohim/shpjegojmë fëmijën. Një perspektivë e re që në njëfarë mënyre përmbys perspektivën e të rriturit që për shumë kohë ka karakterizuar vështrimin me të cilin njeriu ka vëzhguar vetveten. Studimi i fazave të zhvillimit përmes të cilit, duke filluar nga fëmijëria, zhvillohen aftësi dhe zotësi dhe merr formë njohja e botës, rezultoi të jetë një hap i domosdoshëm i kërkimit psikologjik.

Për shumë kohë psikologjia e zhvillimit ka përkuar me psikologjinë e moshës së zhvillimit pasi mendonte se zhvillimi kish të bënte kryesisht vetëm me fazat e para të jetës së njeriut, ato që më pas do të shpinin në gjendjen e të rriturit, e qëndrueshme për nga natyra e vet, e që më pas, në mënyrë të pashmangshme, do të ndiqej nga rënia karakteristike e plakjes. Ky kërkim, që nxori gjithnjë e më shumë në dritë ndikimin përcaktues të fazave të para të zhvillimit, u mbështet në modele metodologjike shumë të ndryshëm,

në skajet e të cilëve mund të shquajmë psikanalizën dhe komportamentizmin. Në të gjitha rastet, pyetja të cilës u është dashur të përgjigjen të gjithë ka të bëjë me faktorët që kryesojnë zhvillimin psikik. Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje u referohet dy lloj faktorëve: të parët që kanë të bëjnë me mjedisin dhe faktorët endogjenë, që lidhen me zhvillimin biologjik.

Komportamentizmi është modeli që e sheh zhvillimin të ndërvarur kryesisht nga ndikimi i mjedisit, që njihet si kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të kuptuar orientimin dhe zhvillimin e sjelljes së individit. Trashëgimia gjenetike në këtë këndvështrim shfaqet vetëm si bartëse mundësish (aftësi, kapacitete, zotësi, etj.) që mund/duhet të rriten por që nuk kanë në vetvete asnjë orientim vlerash. Fëmija është një *tabula rasa* (si një pllakë e bardhë e pashkruar) mbi të cilën përvojat do të lënë gjurmën e tyre të pashlyeshme (Watson): një konceptim pra që mund të përkufizohet si 'përcaktueshmëri rrënjësore e mjedisit' dhe, për rrjedhojë, potencialisht autoritare dhe detyruese në rrafshin formues. Në pasojat mbi modelin pedagogjik ky këndvështrim i zhvillimit duket të jetë shumë afër atij të kundërt, këndvështrimit *biologjik* që interpreton në mënyrë përcaktuese zhvillimin e individit si rezultat i pastër i veprimit të gjeneve dhe të trashëgimisë; ky konceptim, gjerësisht i përhapur në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, duket se sot është lënë absolutisht mënjanë ndonëse shumë prej premisave të tij janë të pranishme në konceptimet më të gjera të psikologjisë shkencore aktuale.

Psikanaliza vlerëson se motori i zhvillimit gjendet në një proces të brendshëm pjekjeje të subjektit dhe sjellja përfaqëson rezultatin e kësaj shtyse apo nevoje të brendshme (S.Freud). Mjedisi përfaqëson elementin strukturues të zhvillimit që vepron kryesisht si frenim i plotësisht të nevojës. Në konceptimin psikoanalitik klasik zhvillimi është gjithnjë i

lidhur me aspektet e pjekjes të llojit endogjen dhe ndodh sipas fazave cilësisht të ndryshme (orale, anale, falike, latente, gjenitale), me një drejtim të saktë. Lind nga kjo nevoja për ta parë edukimin kryesisht si lehtësues të zhvillimit (A.Freud) për të shmangur kështu konfliktin që qëndron në marrëdhënien edukuese.

Ndër dy interpretimet e skajshme të komportamentizmit dhe të psikanalizës qëndrojnë mundësi që kanë të bëjnë me përpjekjen për të parë tek zhvillimi rezultatin e një veprimi gjithnjë e më kompleks ku ndërveprojnë faktorë endogjenë/të brendshëm (biologjikë dhe të trashëgimisë) dhe ekzogjenë/të jashtëm (të mjedisit), edhe pse në secilën prej tyre është e mundur të vërehet gjithmonë një epërsi, të paktën relative, që i takon subjektit apo kontekstit.

Gjejmë më pas *konjitivizmin* (Piazhe dhe Werner) që e përkufizon zhvillimin si rezultat të një veprimtarie vetorganizimi, e bazuar biologjikisht, për t'iu përshtatur më mirë mjedisit, e cila shkaktohet dhe rregullohet nga brenda organizmit. Një peshë të rëndësishme në këtë veprim kanë funksionet sipërore dhe konjitive (apo njohëse) të subjektit. Kjo udhë, cilësore dhe e karakterizuar nga një drejtim i saktë, shquhet nga një diferencim gjithnjë e më i madh me të cilin lidhet një hierarkizim gjithnjë e më i madh. Marrëdhënia me realitetin, fillimisht sinkretike, e përhapur, e papërcaktuar dhe e ngurtë, bëhet gjithnjë e më e diferencuar, e shtrirë, e përcaktuar dhe fleksibël. Inteligjenca realizon formën më të lartë të përshtatjes, pra ekuilibrin më të lartë mes dy veprimeve, të organizmit mbi mjedisin dhe anasjelltas. Edhe në këtë zhvillim përcaktohen fazat që varen nga zhvillimi i strukturave konjitive (ose njohëse) që gjejnë themelin e tyre në organizmin biologjik. Drejtimi i zhvillimit përcaktohet nga kërkimi i një marrëdhënieje më përshtatëse me mjedisin rrethues, në bazë të programimit gjenetik dhe të zhvillimit neurofiziologjik.

Ndërsa një drejtim i dytë i zhvillimit, ai *historiko-shoqëror* (Vygotskij), e sheh zhvillimin si një proces pjekjeje që ndodh përmes marrëdhënies me realitetin: mendja njerëzore strukturohet dhe luan rolin e vet aktiv duke përdorur mjetet (gjuhën, të folur e të shkruar, sistemet e llogaritjes, mjeshtrinë teknike, etj.) që janë përpunuar në rrjedhën e historisë. Proceset psikike sipërore kanë një natyrë shoqërore. Koncepti i veprimit fiton një rëndësi kryesore duke qenë se është mjet ndërmjetësimi mes individit dhe realitetit. Në këtë perspektivë i rrituri fiton një rol specifik dhe të rëndësishëm si udhërrëfyes i zhvillimit.

Një rëndësi të madhe në thellimin e konceptit të zhvillimit ka pasur ardhja e *teorisë së përgjithshme të sistemeve* (von Bertalanffy) që sheh tek sistemi, tërësinë e elementëve në ndërveprim të ndërsjellë, fushën e vëzhgimit e përshtatshme për të kuptuar situatat reale si në nivelin fizik ashtu dhe në atë njerëzor.

Pika kritike e zhvillimit zhvendoset nga një prej faktorëve të lojës (gjenetikë, të trashëgimisë, të mjedisit, etj.) në mënyrën sesi ata vendosen ndaj njëri-tjetrit. *Ndërgjegjësimi* për karakteristikat e marrëdhënies vetjake me botën dhe e mundësive për t'i ndryshuar shihet si pikë kritike që udhëheq zhvillimin (Wallon), orienton reflektimin mbi tërësinë e *marrëdhënieve* që lidhin *individin* me *botën* (Lewin), mbi marrëdhënien e ndërsjellë mes personit dhe mjedisit përcaktuar nga modeli *'person-proces-kontekst'* (Bronfenbrenner), mbi veprimin me të cilin *subjekti*, duke i vendosur në një rend të caktuar, u jep *kuptim* njohurive të fituara (Bruner).

Zhvillimi duket të jetë i kuptueshëm vetëm duke përfutur një kuadër referues të llojit probabilist, olistik, ndërveprues, konstruktivist.

Krahas reflektimit mbi zhvillimin, një ndihmë e mirë për

psikologjinë, e veçanërisht për psikologjinë e zhvillimit, vjen nga reflektimi mbi të *nxënit*, nocion që në shumë raste mbështetet dhe ndërthuret me vetë nocionin e zhvillimit.

Studimet e para specifike nisin me përcaktimin e *kushtëzimit* si karakterizues i marrëdhënies mes individit dhe mjedisit. Në marrëdhënien ngacmim-përgjigje përcaktohet mënyra përmes së cilës përftohet një sjellje e caktuar, të nxënit e vetëm që mund të merret në konsideratë nga psikologjia. Konceptimit të hershëm të kushtëzimit (Pavlov) do t'i shtohet nocioni i *përforcimit* (Skinner), e do të plotësohet më tej me teorinë e të *nxënit shoqëror* (Bandura) ku të nxënit e një sjelljeje dallon nga kryerja në praktikë e saj.

Një kthesë vendimtare vjen në gjysmën e shekullit të shkruar nga afirmimi i *konjitivizmit* që e shtrin çështjen e të nxënit në përfitim e *'strukturave të njohjes'* (skript), pra të formave mendore që udhëheqin dhe ripërpunojnë të nxënit (Piazhe). Konceptit të 'rritjes' së njohurive i shtohen edhe konceptet e 'ristrukturimit' dhe të 'përputhjes' së të nxënit. Vëmendja zhvendoset në proceset metakonjitive tipike të mendjes. Në këtë fazë merr rëndësi nocioni i *'hapësirës së zhvillimit të përfaqësuar'* (Vigotsky), referuar dimensionit mendor, që përcakton hapësirën brenda së cilës mund të ndodhë një rritje e të nxënit siç merr rëndësi *hipoteza konstruktiviste* sipas të cilës vetëm një veprim specifik i subjektit mund të ndërtojë një kontekst që është në gjendje të pranojë siç duhet, me radhë, elementë të ndryshëm të nxëne. (Bruner, Gardner).

Në përfundim

Psikologjia e moshës së zhvillimit zë një vend të rëndësishëm në kuadrin e shkencave të zhvillimit njerëzor: i takon asaj studimi i dukurive dhe i mekanizmave që marrin pjesë në formimin e personalitetit individual. Të gjitha kontributet e

eksperimentimit shkencor modern dhe bashkëkohor kanë hedhur dritë mbi rëndësinë themelore të përvojave të para dhe të “ngjarjeve të para jetësore” subjektive në formimin e strukturave dhe mekanizmave të hershëm të përshtatjes ndaj realitetit, duke u shtyrë gjithnjë e më shumë për të eksploruar fazat më të para të jetës, duke shkuar përtej çastit të lindjes dhe duke hyrë në eksplorimin e jetës së fëmijës ndërkohë që ndodhet në mitrën e nënës.

Këto struktura të para psikike e njohëse, përmes të cilave subjekti krijon vetë marrëdhënie me të tjerët, karakterizohen nga një qëndrueshmëri dhe forcë relative, dhe mund të thuhet se, në tërësinë e tyre, ato përfaqësojnë një lloj ‘matrice formuese’ të hershme që është në gjendje të kushtëzojë në mënyrë përcaktuese të gjitha përvojat e mëvonshme.

Vitet e para të jetës përbëjnë kështu themelin e personalitetit të rritur, mënyrat e përshtatjes dhe shprehjet më karakteristike të të cilit e kanë zanafillën e vërtetë të tyre në nivelin e përvojave të para psikologjike fëmijërore.

Ekziston pra një ndërvarësi e ngushtë mes të tashmes dhe të shkuarës sonë psikologjike. Përvojat e para krijojnë tek ne një sërë strukturimesh përshtatjeje dhe mbrojtjeje që kushtëzojnë, në sasi dhe në cilësi, mënyrat tona të tashme të të qenit: nga pikëpamja sasiore sepse sasia e burimeve tona aktuale (të rritura), mundësitë që ne kemi për të vepruar dhe reaguuar, do të varen edhe nga sasia e energjisë psikike që përdoret në mbrojtjen e nyjeve konfliktuale të pazgjidhura që bartim me vete; nga pikëpamja jonë cilësore sepse mënyrat kryesore të përshtatjes, qëndrimin ndaj të tjerëve, marrin formë në bazë të matricës së hershme të karakterit.

Sidoqoftë, është një çështje që nuk mund të përcaktohet lehtë: ndërkohë që është e vërtetë se rrymat e ndryshme psikologjike i japin rëndësi të ndryshme dimensionit historik individual. Kjo lloj çështjeje flet deri diku qartë për një prej

rreziqeve më të mëdha nga i cili duhet të ruhet psikologjia (ashtu si dhe çdo shkencë tjetër): ai i të ashtuquajturit “reduktivizëm”. Ekziston në fakt prirja që shfaqet në një teori apo në një tjetër për të interpretuar personalitetin dhe sjelljen njerëzore si një temë të vetme, për të reduktuar shkaqet dhe arsyet e të vepruarit në një kategori të vetme faktorësh: në atë biologjike, instiktive, kulturore. Kështu ekziston edhe prirja për të hipertrofizuar rolin e historisë individuale, apo në të kundërt, rolin e shkaqeve të fundit aktuale, si stimuj të përgjegjshëm të përgjigjes së sjelljes së njeriut.

Kurt Lewin bëri dallim mes shkakësisë “historike” dhe shkakësisë “sistematike”. Ndërsa shkakësia historike përfshin të gjithë faktorët që, nga lindja, kanë vepruar mbi zhvillimin e personalitetit individual duke kushtëzuar karakterin e tij, arsyet e tij, inteligjencën e tij, shkakësia sistematike përfshin ata faktorë që veprojnë në një kohë të caktuar, të tashme, mbi sjelljen e individit. Në kohën kur personi bën një zgjedhje, vepron, shpreh një synim, ai ndikohet nga një sërë faktorësh të tashëm, pra nga arsye dhe forca të pranishme që, siç thotë Lewin, përbëjnë “fushën psikologjike të menjëhershme” ku bën pjesë personi.

Ka të ngjarë që disa prej këtyre faktorëve që veprojnë në fushën psikologjike të menjëhershme të jenë të lidhur me faktorë më të hershëm, me përvoja të shkuara; por ajo që ka rëndësi, për të kuptuar dhe shpjeguar sjelljen individuale, është forca e tashme e tyre, aftësia e tyre për të vepruar në kohën e tashme. Një shembull, i marrë nga fusha fizike, mund të sqarojë më mirë këtë opinion të Lewin-it; nëse një litar tërhiqet me shumë forcë dhe këputet, ne mund ta shpjegojmë aksidentin si një dukuri që lidhet me marrëdhënien dinamike mes dy forcave të tashme: rezistenca e litarit dhe forca e tërheqjes të cilës i nënshtrohet. Askush nuk mohon se këputja e litarit lidhet me gjendjen në të cilën ai është ruajtur e pra me prishjen e shkuar të cilës i ish nën-

shtruar litari. Por ajo çka ka rëndësi tani, në një analizë të fundit, është pikërisht rezistenca e tashme e tij si dhe forca e tërheqjes që ai ka marrë.

Pavarësisht nga teoritë e ndryshme dhe nga kundërvëniet e tyre polemike, psikologjia e moshës së zhvillimit ka fituar në vitet e fundit një rëndësi gjithnjë e më të madhe si në fushën e ngushtë shkencore ashtu dhe në atë të zbatimeve praktike: studimi i problemeve të psikologjisë fëmijërore ka qenë një ndihmë e pazëvendësueshme për kulturën bashkëkohore.

Mjekësia për fëmijë (pediatria), pedagogjia, didaktika, neuropsikiatria infantile, sociologjia, shkencat shoqërore në përgjithësi, marrin nga përpunimi psikologjik një sërë

rregullash dhe plotësimesh të domosdoshme për një interpretim më të plotë e më të vërtetë të dukurive normale dhe patologjike të fëmijëve dhe një mundësi më konkrete ndërhyrjeje në fushat përkatëse të interesit.

Nga ana e vet psikologjia fëmijërore nxjerr nga bashkëpunimi ndërdisiplinor me shkencat e tjera mundësinë për një vizion shumëkrahësh të problemeve; bashkëpunimi nuk është vetëm teorik por realizohet në fakt në një sërë nis-mash dhe institucionesh të specializuara për kujdesin ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve; do të mjaftojë të përmendim konsultoret mjekësore-psiko-pedagogjike, qendrat e higjienës mendore fëmijërore, qendrat e orientimit shkollor dhe profesional dhe institutet mjeko-pedagogjike.

Një kuadër referues:

ZHVILLIM DHE MARRËDHËNIE

Ky kuadër referues për vijimësinë e fazave karakterizohet nga dy aspekte, që konsiderohen tejet të rëndësishëm për të kuptuar zhvillimin e subjektit:

- fazat e zhvillimit;
- marrëdhënia, e veçanërisht ato që vendosen në familje, hapësirë absolutisht specifike dhe me shumë rëndësi për zhvillimin e subjektit.

Fazat e zhvillimit

Një perspektivë e bashkëndarë për të gjitha rrymat e ndryshme të psikologjisë së zhvillimit është konceptimi i zhvillimit në faza. Kuadri përmbledhës i fazave të zhvillimit psiko-shoqëror që sillet nga Erikson, të cilit do t'i referohen trajtesat sa vijojnë, përfaqëson një përmbledhje veçanërisht domethënëse e kësaj perspektive. Secila prej fazave të përcaktuara shihet si një *pikë krize* që, duke qenë se është kuptuar dhe zgjidhur, i hap udhë një *përftimi zhvillues* specifik i cili identifikohet në një 'forcë bazë' që karakterizon fazën e zhvillimit në fjalë duke qenë fazë e një zhvillimi harmonik të subjektit.

Fazat e zhvillimit psikosocial sipas Erikson

	mosha e pleqërisë (nga 60 vjeç e më tej)	<i>integriteti ndaj dëshpërimit</i> Forca bazë: mençuri
	mosha e rritur (25-59 vjeç)	<i>të qenit krijues ndaj të mos vepruarit</i> Forca bazë: kujdes
	rinia (20-24 vjeç)	<i>intimiteti ndaj izolimit</i> Forca bazë: dashuria
	adoleshenca (12-19 vjeç)	<i>identiteti ndaj konfuzionit të identitetit</i> Forca bazë: besnikëri
	mosha shkollore (6-11 vjeç)	<i>të qenit veprues ndaj inferioritetit</i> Forca bazë: aftësi
	mosha e lojës (3-5 vjeç)	<i>nisma ndaj ndjenjës së fajit</i> Forca bazë: qëllim
	fëmijëria e parë (19 – 36 muaj)	<i>pavarësia ndaj dyshimit dhe turpfit</i> Forca bazë: vullnet
	fëmijëria (deri në 18 muaj)	<i>besimi ndaj mosbesimit bazë</i> Forca bazë: shpresa

Një skemë e dytë, e cila bën vend në perspektivën e sjellë nga Erikson, plotëson aspektet që kanë të bëjnë me zhvillimin afektiv-marrëdhënor me aspekte që kanë të bëjnë me zhvillimin njohës, duke përcaktuar një vijë zhvillimi që tregon kujdes ndaj dimensionit edukues.

Zhvillimi global (afektiv dhe njohës) dhe rritja e aftësisë për marrëdhënie		
0-3 vjeç	të ndërtosh besimin	varësi
3-6 vjeç	të rritesh i pavarur	varësi e dytëshme
6-12 vjeç	të rritesh në shkollë, me shokët e shoqet	drejt dialogut
12-18 vjeç	të dëshirosh të jesh i pavarur	ndërsjellës
0-1 vit		
jeta në mitër		mendimi senso-motor
shkrirja me nënën		loja perceptuese motore
drejt përcaktimit		qëndrueshmëria e objektit
1-2 vjeç		
Mosha e kundërshtimit		mendimi senso-motor
Të fituarit e pavarësive: - ushqim, lëvizje, / - kontroll sfinkterik apo i jashtëqitjes		fillimi i mendimit simbolik
2-3 vjeç		
kriza e edipike: nëna, babai, fëmija		mendimi simbolik
procesi i identifikimit seksual		gjuha, loja simbolike
3-6 vjeç		
Lindja e ndërgjegjes morale		mendimi simbolik
Grupi i bashkëmoshatarëve		gjithnjë e më pak “egocentrik”
Disiplina, rregullat		
6-12 vjeç		
Marrëdhëniet e miqësisë		Mendimi veprues-konkret
Marrëdhënia me të rriturin: prind, mësues...		mosha “krijuese”
12-18 vjeç		
Pyetjet kryesore		Mendimi abstrakt
Kush jam / Nga vij / Cili është fati im		
Edukatori duhet të ndihmojë të edukuarin të përballojë problemin për t'u bërë vetvetja		
Prandaj edukatori duhet ‘të kujdeset’, dhe kjo ndodh me dy lëvizje të kundërta dhe plotësuese: <ul style="list-style-type: none"> • ofron mbrojtje / • lë hapësirë 		

ZHVILLIMI I PERSONIT NË MARRËDHËNIET FAMILJARE



Ajo çka që në zanafillë mbështet jetën tonë fizike dhe psikike është një marrëdhënie.

Identiteti personal, nga pikëpamja psikologjike, përcaktohet si “të jesh në marrëdhënie me”.

Fjala “identitet” do të thotë barazi, ngjashmëri, por,

njëkohësisht do të thotë të jesh unik, veçanti, ndryshim.

Termi identitet të shpie në një “tjetër” pol ndaj të cilit jemi të gjithë “të barabartë” dhe “të ndryshëm”: bëhet fjalë për një koncept të mirëfilltë marrëdhënor.

Kur bëhet fjalë për identitet flitet pra për marrëdhënie.

E vërteta paradoksale e njeriut përfaqësohet nga fakti se ne mund të njihemi si individë më vete vetëm në masën në të cilën jetojmë në marrëdhënie me të tjerët, dhe se mund të kemi përvojë të “të qenit në marrëdhënie me” vetëm në masën në të cilën mësojmë ta dallojmë tjetrin nga ne.

Identiteti personal është për këtë arsye rezultati i një procesi që lubet brenda një përkatësie.

Duke pasur parasysh sa më sipër kuptohet përse zhvillimi i një individi nuk është një çështje që ka të bëjë vetëm me të por është një aventurë zhvilluese e përbashkët e subjektit në rritje dhe e atij që kujdeset për të.

Udha drejt identitetit

Por çfarë do të thotë që identiteti rrjedh nga përkatësia?

Për të kuptuar rrjedhojat e këtij pohimi duhet të përshkujmë së bashku një drejtim, e pikërisht drejtimin e udhës drejt identitetit.

Cila është “shtëpia” e parë, vendi i parë konkret të cilit i përkasim?

Përgjigja është e qartë: vendi i parë që na mikpret është mitra.

Nga ngjizja, deri në lindjen fizike, mitra është mjedisi i parë, mjedisi i parë të cilit i përkasim, dhe nis pikërisht aty jeta marrëdhënore e fëmijës.

Në barkun e nënës, çdo krijesë është në gjendje t’u përgjigjet ngacmimeve të caktuara, ka një veprimtari të pasur motore, dhe sipas mënyrës së vet merr pjesë në jetën emocionale të nënës.

Por në mitër fetusit jeton në një mjedis të ekuilibruar, të mbrojtur dhe, në kohën e lindjes, është i detyruar të përballojë një numër të ndjeshëm ngacmimesh të jashtme.

Fillon duke eksperimentuar papritur presionin atmosferik dhe një temperaturë të ndryshme dhe të ndryshueshme; ngacmimet pamore, akustike, të prekjes, që në njëfarë mënyre kish mësuar t’i njihje, tani i shfaqen në një pamje të re, jo më topitura nga lëngu amniotik, por shumë më të forta dhe agresive.

Pikat referuese me të cilat ish mësuar, si rrahjet e zemrës së nënës, nuk dëgjohen më krejt papritur dhe, për herë të parë, ai jeton përvojën e “të pasurit nevojë”, jeton përvojën e “nevojave”, ndërkohë që më parë ato plotësoheshin pothuaj sa lindnin.

Përvoja e “mungesës”, e “të pasurit nevojë për”, të pasurit uri për shembull, është një përvojë e re për të sapolindurin; në të vërtetë në mitër nevojat plotësoheshin edhe përpara se të lindnin. Tani ndodhet në një gjendje nevojë që s’e ka provuar kurrë më parë.

Ja sesi ndeshja e gjithë këtyre veprimtarive që duhen përballuar, bën të lindë tek fëmija nevojën për “t’u mbrojtur”, për të fituar kohë, për t’iu përshtatur rrethanës së re duke e përshkallëzuar dhe përshtatur dalëngadalë ndaj aftësive të veta për të duruar.

Ndoshta për këto arsye foshnja, në ditët e para të jetës së vet, fillon të jetojë sërish sikur të qe ende në barkun e nënës, sikur nëna e tij të ish një shtrirje, një zgjatim i “vetvetes” së tij.

Fëmija, ndonëse menjëherë ka një veti të theksuar për të komunikuar, duke qenë se është formuar brenda trupit të nënës, në çastin e lindjes, ka këtë bashkim me të si përvoja e tij e vetme mendore: ai dhe nëna e tij janë e njëjta gjë, janë të shkrirë, janë në një gjendje “bashkë-shkrirjeje” (pleksjeje), “shkrirjeje-me”. Ja sepse flitet për një gjendje shkrirjeje me nënën.

Por vazhdimësia e përkujdesjeve që foshnja merr dhe qëndrueshmëria e pranisë së nënës (apo e kujt kujdeset për të), bëjnë që të zërë vend vetëdija se “tjetri më vete”, ekziston, dhe është pikërisht ai që plotëson nevojat e tij.

Të prekesh, të shihesh, të ngrohesh, të ushqehesh, të lahesh, është kushti që foshnja të nisë të perceptojë një kufi trupor mes lëkurës së tij dhe botës, është kushti për të dalë nga gjendja mendore e bashkëshkrirjes, e pleksjes për të cilën folëm për të shkuar drejt perceptimit të një vetveteje të identifikuar dhe më vete.

Vetëm në këtë çast mund të flasim për lindje psikike.

Në këtë pikë fëmija nuk e di ende “kush është” por di “çfarë është”, që ekziston, dhe këtë zbulim të parë, të mrekullueshëm ai e bën falë marrëdhënies me “tjetrin vetë” që është figura e nënës apo e atij që kujdeset për të.

Por kjo aventurë duket të jetë tipike për qenien njerëzore.

Në fakt, në botën e kafshëve, këlyshët bëhen të pavarur shumë më shpejt: një fëmijë ngrihet në këmbë për të ecur pothuaj kur është një vjeç, ndërsa një mace, një qen, një kalë, vetëm pas pak orësh.

Është vetëm një kafshë që mund ta krahasojmë me këlyshin e njeriut: këlyshi i kangurit. Në fakt, për të takuar botën ky këlysh ka nevojë të qëndrojë për një periudhë të caktuar në xhepin e nënës, që, duke ofruar këtë mbrojtje, duket se e përgatit dalëngadalë për takimin me realitetin.

Për qenien njerëzore ky “xhep” janë krahët e atij që e pranon në lindje dhe që, dalëngadalë, e fut në takimin me botën.

Përvoja e të afruarit në fakt, është në varësi të ndarjes, sepse personi, duke u nisur nga kjo bazë e sigurt, rrezikon takimin me realitetin.

Lindin në këtë pikë disa mendime.

Duke vëzhguar këtë udhë shohim me qartësi sesi lindja psikike nuk përkon me lindjen fizike.

Ndërsa e dyta është një ngjarje shumë e saktë dhe e përpiktë në kohë (e di me saktësi ditën dhe orën në të cilën kam lindur), lindja psikike është një proces i ngadaltë, i përbërë nga vajtje-ardhje, një proces që supozon një bazë sigurie që vetëm një përvojë e një përkatësie të thellë dhe të plotë mund ta japë.

Duket një paradoks, por përkundrazi është diçka e qartë: për të thënë ‘Unë’ kam nevojë për një ‘Ti’; që do të thotë: të mund të thuash “Unë” kam nevojë për dikë të cilit i përkas. Atëherë mund të themi se barku i nënës bën të mundur lindjen fizike, ndërsa përvoja e të përkulturit dikujt që të njeh si bir/bijë, bën të mundur lindjen psikike.

Njeriu vjen në botë duke banuar fizikisht brenda një personi tjetër, por, pas lindjes, mund të vazhdojë të jetojë vetëm nëse gjen menjëherë një tjetër vend që bëhet shtëpi për të.

Ky vend janë mendja, zemra, krahët, prania fizike dhe psikike e nënës dhe e babait apo e atij që bëhet baba e nënë për të. Gjithmonë, në çdo kulturë e në çdo kohë, njeriu shpreh që në lindje këtë nevojë të tij themelore, nevojën për përkatësi, nevojën për të “banuar” brenda një tjetri.

Nga ana tjetër personi vazhdimisht në jetën e tij, pavarësisht nga mosha që ai ka dhe nga gjendja në të cilën ndodhet,

“vjen në botë” gjithmonë, pra hedh hapa rritjeje, duke shkuar të banojë tek dikush tjetër.

Por nevoja për përkatësi përkon edhe me nevojën për t’u njohur: fëmija shkon të banojë në këtë banesë (i rrituri që bëhet shtëpi për të dhe e njeh si bir), dhe në këtë përkatësi të tij, bëhet vetvetja.

Le të ndalemi tani tek pozicioni i të rriturit, tek kuptimi i të qenit të tij “vend që mikpret” në marrëdhënien me fëmijën.

I rrituri, për nga struktura e tij, për nga natyra e tij, është “prind”.

Ai, pikërisht sepse është i rritur, e bën pjellor mjedisin që ka përreth, ndërton, është i aftë të lindë a gjenerojë, të krijojë, t’u japë jetë ngjarjeve në punën e vet, në jetën e vet. Por termi “të gjenerojë/të lindë” na sjell ndërmend një dimension më të gjerë të termit “të lindësh/të sjellësh në jetë”.

Në të vërtetë lindja apo sjellja në jetë është një akt i përpiktë e që i takon më shumë botës fizike; ndërsa të gjeneruarit, apo krijuarit të sjell ndërmend një proces që shtrihet në vite e që edhe mund të përkohë me të qenit prindër biologjikë.

Atëherë mund të themi se një i rritur, duke qenë i rritur, “gjeneron/krijon”; në kuptimin që kujdeset për atë që takon në udhën e tij. “Të gjeneruarit/të krijuarit” shtrihet në fakt në të “përkujdesurit për”.

Marrëdhënia e të rriturit me fëmijën (prind, edukator, punonjës social...) shprehet me “përkujdesjen”, përkujdesje që përfshin njëherësh aftësi mbrojtëse dhe aftësi për të lënë hapësirë, aftësi për të qenë i afërt dhe aftësi për të qëndruar larg, që fëmija të mund të ecë i sigurt drejt të qenit i pavarur.

Janë të pranishëm tek individit në fakt si nevojat për të pasur lidhje (nevoja për përkatësi) ashtu dhe nevojat për të qenë i lirë (nevoja për t’u ndarë a shkëputur) dhe dialektika e përjetshme mes të parave e të dytave është shkaku i dinamizmit të jetës psikike. I rrituri që merret me fëmijën, pavarësisht nga e drejta apo pozicioni i tij, duhet të kujdeset për këto

nevoja.

Sigurisht, nevojat e fëmijës së vogël për të eksploruar luhën me të rriturit afër, prandaj mund të mos shfaqen bujshëm por mund të jenë njësoj të pranishme; anasjelltas, tek adoleshenti, shfaqen më qartë nevojat për t’u shkëputur, ndërsa ato për mbrojtje vazhdojnë të jenë të heshtura, aq sa mund të censurohen nga kultura jonë, ndërkohë që duhet të merren përsipër deri në fund.

Dhënia e “kujdesit” e shoqëron fëmijën/bir përgjatë gjithë kohës së rritjes së tij: nga “holding” i vazhduar që siguron mirëqenien fizike e psikike të fëmijës shumë të vogël, tek “siguria” që i jepet fëmijës që jeton përvojat e tij të para në kuadrin jashtë-familjes, tek “mbrojtja fleksibël” me të cilën mbështetet adoleshenti në përpjekjet e tij drejt të qenit i pavarur.

Për këtë arsye, “të kujdesurit për” përfshin dy aspekte themelore: burimi i afektit dhe respektimi i ligjit dhe me të, i rregullave.

“Ligji” është parimi rregullues i sjelljeve njerëzore, që i jep kuptim dhe drejtim të vepruarit. Afekti i jep mundësi fëmijës të përvetësojë vitalitet, ngrohtësi, besim, vetëvlerësim, aftësi për të pasur marrëdhënie. Ligji, pra kuptimi i asaj që është e mirë, e drejtë dhe e asaj që është e keqe, e padrejtë, e vendos përpara kufizimit duke e ndihmuar të kuptojë realitetin e jashtëm, fizik e shoqëror, me të cilin duhet të matet dhe në të cilin duhet të bëhet pjesë dhe të japë kontributin e tij konstruktiv. Rregulli, i kuptuar si drejtim dhe jo si kufi, ndihmon atë që rritet të dallojë vetveten nga të tjerët (duke u njohur atyre të drejta të barabarta), të përmbajë impulsset e veta të dhunshme a shkatërruese, të edukohet ndaj ndërsjellësisë në marrëdhënie.

Në njohjen e realitetit të jashtëm ekziston parakushti i lirisë së vërtetë. Prandaj, në mënyrë paradoksale, rregulla ndihmon dhe mundëson lirinë.

Pra i rrituri duhet të garantojë njëkohësisht cilësinë e lidhjes afektive (mbrojtje) dhe mbështetjen për nevojën për të

eksploruar (për të lënë hapësirë), eksplorim i cili duhet të drejtohet nga rregulla të qarta. E gjitha kjo pa lënë kurrë pas dore faktin që, për fëmijën, “rregulla” e parë jam unë duke qenë i rrituri që e shoqëron atë, është personi im, është marrëdhënia me mua.

Na qëllon shpesh të veprojmë në rrethana ku nevojat e fëmijës (afekt dhe ligj) mohohen. Rrethana të tilla si lënia pas dore, braktisja (të shoqëruara me varfëri të madhe, konflikte të rënda shoqërore, privime materiale e kulturore, shfrytëzimi, puna e të miturve), duket se e privojnë fëmijën nga të dyja format e përkujdesit, si nga afekti ashtu dhe nga ligji. Në paradoks, shpesh herë është shumë e vështirë të ndihmohen këta fëmijë, ndërkohë që kanë kaq shumë nevojë për ndihmë, sepse ata janë mosbesues ndaj gjithë njerëzve që, pavarësisht përse, kanë një pozicion autoritar, edhe profesional, dhe druajnë marrëdhëniet sapo ato bëhen të afërta dhe intime. Ata mësojnë shpejt, duke reaguuar, të nxjerrin në pah koracën e mosbesimit dhe cinizmit dhe të kenë sjellje të papranueshme që shkaktojnë reagime ndëshkuese dhe mospranimi nga ana e kontekstit shoqëror. Pra, nga ana e vet, përforcon ndjenjën e tyre të papërshtatshmërisë dhe të përcmimit të vetvetes.

Ndërsa kur i rrituri është në gjendje të ofrojë një marrëdhënie që mbështetet vërtet tek “përkujdesja” (që pamë të shtjellohej në mënyrat e afektit dhe të ligjit), fëmija përgjigjet me besim.

Besimi është përgjigja që fëmija zhvillon nëse prindi, apo i rrituri më afër tij, është vërtet i denjë të besohet.

Synimi i edukimit është pra jo aq pavarësia emocionale sesa besueshmëria e lidhjeve.

Sa më të sigurta janë lidhjet, aq më e madhe do të jetë forca emocionale dhe forca e qëndresës përballë jetës.

Kënaqësia e të eksploruuarit duhet ndihur, dhe ndihet në masën në të cilën i rrituri që kujdeset për fëmijën ndih tek ai brendësimin e një afrimi të qëndrueshëm, të fortë, pra, siç e theksuam më lart, besimin, besueshmërinë e lidhjes.

Fjala besueshmëri përshkruan shumë mirë një marrëdhënie mbi të cilën dihet se mund të mbështetesh. Mund të mbështetesh në një marrëdhënie nëse, kur ke nevojë për të, mund ta kesh; por kur është koha e eksplorimit, e riskut vetjak, kjo marrëdhënie e besueshme të lë të shkosh.

I rrituri jep ndihmën e tij dhe të lë të shkosh.

Nga sa më lart, kuptohet përse zhvillimi i personit nuk është një sipërmarrje që ka të bëjë vetëm me të, por përkundrazi është një aventurë zhvilluese e përbashkët e subjektit në rritje dhe atij që kujdeset për të dhe rritet me të.

Referime bibliografike,

- F. Dolto, *Le parole dei bambini e l'adulto sordo*, Mondadori, Milano, 1988.
- K. E. Grossmann, K. Grossmann, *Legame di attaccamento infantile e sviluppo delle dinamiche psicologiche individuali nel corso della vita*, 1993, në *Terapia familiare*, 1993, n. 41.
- V. Sanese Maioli, *Ho sete per piacere*, Edizioni Marietti, 2004.
- E. Scabini, V. Cigoli; *Identità adulta e relazioni familiari*, në *Studi Interdisciplinari...*, n. 10, Vita e Pensiero, Milano, 1991.
- E. Scabini, *Lo sviluppo della persona*, në *Iniziare*, giugno, 1997.
- D. Winnicott, *Gioco e realtà*, Armando, Roma, 1974.

NJË VËSHTRIM MBI FËMIJËRINË



Zotësia për të vendosur marrëdhënie është “aftësia” që karakterizon dhe përkufizon qenien njerëzore.

Në fakt lindja psikologjike e individit përkon me aftësinë e tij për t’u vendosur në marrëdhënie me dikë tjetër, të rëndësishëm (nëna) dhe pjekja apo maturimi i tij me aftësinë për të vendosur marrëdhëniet e duhura, pra shkëmbime të thella me personat që përbëjnë mjedisin e tij familjar e shoqëror.

Kjo aftësi për të pasur marrëdhënie ndjek një trajektore që idealisht duket se shpie nga një marrëdhënie jo e maturuar në një më të maturuar, duke pasur parasysh se në realitet kjo vijë rritjeje ndërpritet nga “kriza” maturimi që e bëjnë të vështirë rrugën.

Nga varësia në ndërsjellësi

Mund të përcaktojmë kështu itinerarin që përshkruan udha e marrëdhënies prind/fëmijë, por edhe të gjitha marrëd-

hëniet me individët e tjerë të rëndësishëm (edukatorë, mësues...).

Varësia përcakton një mënyrë kryesuese dhe tipike të fazave më të hershme të jetës së qenies njerëzore, por mënyra që varen nga marrëdhënia mund të rishfaqen edhe në periudhat e mëtejshme të jetës. Një mënyrë që varet nga marrëdhënia mund të shfaqet kur nuk dihet si të vendosen kufij të qartë mes vetes dhe tjetrit.

Nëse një mënyrë e varur vazhdon gjatë atëherë ajo nuk zhvillon aftësinë që qenia njerëzore ka për të pasur mënyra të diferencuara marrëdhënieje, aftësinë për të njohur realitetin, si dhe frenon nevojat për të eksploruar.

Një mënyrë e ndërmjetme mes varësisë më të hershme dhe dialogut më të maturuar është ajo që mund ta quajmë varësi të dytëshme. Kjo mënyrë karakterizohet nga konflikti mes prirjeve progresive që shpien në diferencim, dhe prirjeve të tashme regresive për t’iu kthyer varësisë.

Çasti i mëtejshëm i kësaj trajektoreje e shpie individin “drejt dialogut” ku duket se ka një pozicion intimiteti në largësi, ku Uni dhe Ti-ja plotësojnë njëri-tjetrin dhe nuk janë bashkë-shkrirë.

Në dialog dhe në ndërsjellësi pranohen dallimi, alteriteti dhe ndryshimi, si aspekte të pasurimit të ndërsjellë, sepse ata bëhen pjesë në një kontekst besimi dhe vitaliteti bazë, që janë karakteristikat e marrëdhënies së shëndoshë njerëzore.

Për këtë arsye cilësia e mirë e një marrëdhënieje vjen nga aftësia për të baraspeshuar nevojat për afërsi dhe nevojat për t’u shkëputur, nevojat për përkatësi dhe për liri vetjake.

Në këtë marrëdhënie do të shtjelloj rrugën që ndjekin fazat e zhvillimit përmes një këndvështrimi të dyfishtë: atij afektiv dhe atij njohës (konjitiv). Këto dy dimensionet janë pazgjidhshmërisht të lidhura por për arsye “didaktike” do të paraqiten njëra pas tjetrës.

Vitet e para të jetës (0-6 vjeç)

Të lindësh do të thotë të ndahesh, të lësh një vend të ngrohtë dhe mikpritës ku jemi strehuar për nëntë muaj, për të përballuar botën me gjithë sa të paparashikueshme ajo sjell.

Për herë të parë foshnja ndien “gjendjen e nevojës”, jeton përvojën e “mungesës”. Por, menjëherë, e gjen veten edhe duke jetuar përvojën që është dikush që u përgjigjet nevojave të saj, dikush në gjendje t’i plotësojë ato.

Që të mund të rritësh një person ai duhet të ndiejë se e duan dhe e kuptojnë. Kur foshnja shpreh nevojën e vet duke qarë, duke lëvizur këmbë e duar....., nëna përpiket të interpretojë dëshirat e saj: do ketë nevojë për përkëdhelje? do ketë uri? ndihet e lagur?...Fëmija nuk e di çfarë do, thjesht bën me dije sesi ndihet. Marrja e një përgjigjeje për sa komunikon, i jep asaj ndjesinë se po ndihmohet dhe e pengon të provojë një ndjenjë shpërbërjeje. Nëna, me aftësinë e saj për të “marrë me mend”, pra duke interpretuar për të atë çka ai ndien dhe duke i dhënë kuptim, është njësoj sikur ta mbante të bashkuar mendërisht. Falë kësaj përvoje fëmija mëson të njohë ndjesitë, emocionet, përvojat e tij dhe t’u japë atyre një trajtë, duke nisur kështu procesin e komunikimit dhe të të kuptuarit të ndërsjellë.

Përvoja e kontaktit me nënën, kaq e nevojshme dhe e qenësishme për krijimin e identitetit bëhet që fëmija të ndahet, të shkëputet, të përcaktohet si person më vete.

Të përcaktohesh do të thotë të ndahesh, të shkëputesh; të ndahesh është e dhimbshme, e mundimshme, por është një përvojë e nevojshme dhe e pashmangshme.

Babai është ai që e mbështet këtë proces ndarjeje duke e shoqëruar dhe ndihur atë. Ndërsa nëna e ndërfton të birin biologjikisht në jetë, babai e ndërfton atë në realitet. Le të kujtojmë shkëmbimin që ndodh në kohën e lindjes: fëmija çohet deri në atë çast, më pas, kur nëna e sjell në jetë, gjen krahët e babait. Nuk gjen vetminë, zbrazëtinë, gjen krahët e babait që e mbajnë dhe e mbështesin në realitet.

Një baba që e njeh i thotë: “Ti je biri im”.

Babai i shkakton birit plagën e parë: ndarjen nga simbioza me nënën.

Dalja nga qarku nënë-bir, përkon natyrisht me heqjen dorë nga plotfuqia.

Procesi i rritjes është pra një proces ndarjeje dhe i përcaktimit të unit.

Nga zero në gjashtë vjeç, fëmija hyn vazhdimisht në marrëdhënie, në fillim me nënën, më pas me babanë, për t’u ndarë prej tyre dhe së fundit për të thënë “unë”. Është një proces në të cilin fëmija brendëson gjithnjë e më shumë praninë e tyre aq sa është në gjendje t’i bëjë të pranishëm edhe kur fizikisht nuk janë.

Në gjithë këtë, të kundërshtosh për fëmijën do të thotë të kesh mundësi për të thënë: “unë jam unë dhe ti je ti”.

Gjendemi përballë një konflikti, një dyvlershmërie: nga njëra anë fëmija ka nevojë të vihet përballë prindit për ta brendësuar atë, nga ana tjetër ka nevojë të thotë: “unë nuk jam ti”, që të mund të eksperimentoj unin e vet. Ai duket se ka njëkohësisht dy nevoja: të jetë i përmbajtur dhe të afirmojë unin e vet. Nga ana tjetër të gjithë ne jetojmë brenda këtij fluksi të dyfishtë që nga njëri krah është të qenit unë, nga tjetri të qenit një un që merr mundësinë për të thënë unë vetëm një marrëdhënie.

Dinamizmi i jetës psikike luhet brenda një luhatjeje të vazhduar, brenda një lëvizjeje të dyfishtë:

- nevoja për të qenë afër/nevoja për të qenë larg;
- prirje për t’u shkrirë/tension për të qenë ndryshe;
- nevojë për t’u afruar/dëshirë për t’u ndarë, shkëputur.

Studime të fundit të Infant Research flasin për një “kompleksitet mendor” të të sapolindurit, kompleksitet që shfaqet si ndërlojë mes nevojave, shqetësimit, dëshirës për të njohur, që të orientohet për të kuptuar cilët janë personat që merren me të, dëshirë e madhe për t’u kthyer siç ishte më parë.

Këlyshi i njeriut është pra i ndarë mes mallit dhe shpresës,

mes të shkuarës dhe të ardhmes, një kontradiktë që do të përbëjë një tipar njerëzor dallues dhe jetëgjatë përgjatë gjithë jetës.

Nëse nëna “njeh” fëmijën krijohet një kusht për fillimin e jetës mendore.

Pra, fillimi i jetës mendore të fëmijës shënjohe nga ndjenja se ekziston, njihet, se pranohet për atë që ai është.

Qëllimi i eksplorimit është besimi, dëshira për të njohur nis nga ky besim që realiteti meriton të njihet.

Me rritjen e moshës fëmijët, kur hyjnë në kopsht (3 vjeç) arrijnë në një lloj ndarjeje mes realitetit të brendshëm dhe të jashtëm, pra me një lloj vetëdijeje për vetveten dhe fillimi i kësaj përvoje është mundësia që fëmija ka për një takim me një realitet më të gjerë jashtë familjes, por edhe për të arritur një përcaktim më të mirë të karakteristikave të veta.

Fëmijët në moshën tre vjeç shfaqin një lloj brishtësie nga një pikëpamje motive që lidhet mbi të gjitha me takimin me një realitet jashtë familjes ku fëmija tashmë kish arritur sigurinë që ajo ç’ka kish komunikuar qe kuptuar dhe dëgjuar, tani bëhet një ndër shumtë të tjerë.

Përveç kësaj, nga pikëpamja afektive fëmija fillon të jetojë atë që psikologët e quajnë “kompleksi i Edipit”, pra ajo tërësi ndjenjash që do ta bëjnë fëmijën të dallojë identitetin e vet seksual përmes identifikimit me prindin me të njëjtin seks. Njëkohësisht, përpunimi i problematikës edipike shpie në ndërtimin e një morali ende primitiv: fëmija brendëson sjelljet, nevojat, atë çka prindërit i ndalojnë, por meqenëse mendimi fëmijëror karakterizohet ende nga egocentrizëm dhe dualizëm, ndërgjegjja morale duket e ngurtë dhe e sunduar nga ligji i luftës “sy për sy, e dhëmb për dhëmb”.

Të lidhur me problematikën edipike mund të shfaqen në këtë periudhë tique dhe frikëra.

Disa vëzhgime mbi rrafshin njohës:

Piazhe, shumë vjet më parë tha diçka që është ende shumë

aktuale: “mendimi është veprim”.

Pra, veprimi nuk është diçka që i paraprin mendimit, por është mendim.

Ky koncept është në fakt ende shumë i vyer për ne, kjo periudhë e parë quhet periudha senso-motore, ose faza e inteligjencës perceptuese-motore.

Fëmija mëson pra të organizojë informacionet që mbërrijnë nga organet e tij të shqisave duke arritur të ketë një ide gjithnjë e më të saktë për objektin që ka përpara, e të gjithë këtë e mëson përmes lëvizjes, ndjeshmërisë dhe, natyrisht, duke u mbështetur afektivisht nga figura e tij referuese.

Qëndrueshmëria perceptuese dhe afektive e botës së jashtme mbështetin procesin mendor që e shpie në përfundimin e “qëndrueshmërisë së objektit”, fitore jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin mendor dhe afektiv, fitore që bëhet e mundur nga prania e qëndrueshme dhe e vazhduar e një të rrituri që përgjigjet i cili është në gjendje të ofrojë vazhdimësi, afekt dhe prani të qëndrueshme.

Në vitin e dytë të jetës fillon një lëvizje intelektive e re dhe interesante që vazhdon dhe thellohet në vitet e mëvonshme: bëhet fjalë për periudhën e intuitës, për fazën e inteligjencës përfaqësuese.

Fëmija bëhet i aftë të përfaqësojë mendërisht atë çka nuk sheh, dhe të vërë në marrëdhënie këto përfaqësime me të dhënat që percepton në çast. Për shembull, nëse më bie një lodër poshtë divanit jam në gjendje të mendoj që shkopi i fshesës që është në kuzhinë mund të më shërbejë për të zgjatur krahun tim dhe ta përdor për ta afruar atë. Loja simbolike dh gjuha janë veprimtaritë mendore që ushqejnë mendimin simbolik.

Me zhvillimin e lojës simbolike dhe të aftësisë për të folur, objektet, që pak më parë përfaqësonin vetëm vetveten nisin të marrin kuptime që vijnë nga përvoja të brendshme dhe të jashtme të fëmijës (karrigia e përmbysur bëhet makina me të cilën babi më shpie në kopsht). Tani është në gjendje të përfaqësojë mendërisht atë çka nuk sheh dhe objektet fito-

jnë një vlerë simbolike. Duke luajtur dhe duke komunikuar me fjalë fëmija stërvit inteligjencën e tij, shpreh emocionet e tij dhe mendimin e tij. Loja simbolike është “kuzhina” e emocioneve të fëmijës. Të luash do të thotë të mësosh, të luash do të thotë të shprehësh dhe kontrollosh ndjenjat e tua. Gjatë vitit të parë të kopshtit fëmijët mund të plotësojnë përfundimin e disa pavarësive të tyre (të rrinë pastër, të hanë vetë, etj.,) që ndonëse kërkojnë mund nga fëmijët, i bëjnë ata të ecin përpara duke qenë më të sigurt në vetvete. Loja në vitin e parë të kopshtit është vetëm e llojit paralel: fëmijët kërkojnë njëri-tjetrin dhe janë të kënaqur të rrinë së bashku, dyshe apo treshe, çdo fëmijë është i ndjeshëm ndaj pranisë së të tjerëve por veprimtaria e tij mbetet individuale.

Për sa i takon gjuhës, fëmija fillimisht e zgjeron fjalorin dhe përmirëson sidomos përdorimin e gjuhës, por duke filluar veçanërisht nga mosha katër vjeç bëhet e dukshme lidhja mes mendimit dhe gjuhës, aq sa kjo moshë quhet mosha kur fillohet të flitet.

Të nxëni si zbulim i realitetit dhe përvetësimi i tij ndodh me shumë shpejtësi; nis organizimi i realitetit sipas formave vetjake të inteligjencës.

Fëmija katërvjeçar duket shpesh shumë aktiv, por jo gjithmonë është po aq i thelluar: priret të vihet në qendër të vëmendjes, madje tallet e luan, është në moshën e mesme dhe duhet të kërkojë një rol të vetin.

Në vitin e dytë të kopshtit shfaqet në fillim loje grupi me konflikte të herëpashershme që e shtojnë fëmijën të kërkojë figurën e të rriturit.

Duke filluar nga mosha pesë vjeç ka dy fusha që zhvillohen me shpejtësi; nga njëra anë aftësia motore e përgjithshme dhe e mjetit dorë, nga tjetra autonomia vetjake në kuptimin objektiv: fëmija është në gjendje të organizohet vetë në veprimtari të vogla pa ndërmjetësimin e të rriturit, pra është në gjendje të luajë me të tjerët.

Brendësimi i disa rregullave i jep mundësi fëmijës të kon-

trollojë më shumë sjelljen e tij.

Mosha e shkollës fillore (6-12 vjeç)

Fëmijët që nisin shkollën fillore kanë bërë sigurisht dallimin mes vetvetes dhe jo vetvetes, mes realitetit të brendshëm dhe atij të jashtëm, pra ky dallim mes “unë” dhe “ti” është bërë.

Sidoqoftë në këtë periudhë i rrituri duhet të jetë i vetëdijshëm se është gjithnjë “ti-ja” domethënëse me të cilën fëmija përballet.

Thellohet e pasurohet procesi i përcaktimit të përcaktimit të identitetit të tij përmes zbulimit të asaj çka ai di të bëjë dhe të asaj që ai është në marrëdhënie me të tjerët.

Krahas këtyre nevojave për identitet dhe përkatësi qëndrojnë nevojat për t’u shprehur; jo rastësisht fëmija në shkollën fillore përfiton disa mjete: ka nevojë të shprehet dhe duke u shprehur të arrijë vetëdijen për vetveten nga një pikëpamje trupore, gjuhësore e grafike.

Kjo periudhë duket se është veçanërisht pjellore për zhvillimin intelektual dhe shoqërizimin.

Por shkolla fillore ka një strukturë të veçantë: fëmija nuk vjen vetëm për të luajtur por për të mësuar dhe ky është objekti i vlerësimit për të rriturit e për veten.

Shkolla fillore ka gjithashtu rregulla sigurisht më të rrepta në krahasim me ato të kopshtit dhe kjo kërkon që fëmija të ketë një aftësi të madhe vetëkontrolli (të tregojë vëmendje, të shtyjë për më vonë atë që do donte të bënte menjëherë, të kontrollojë sjelljen e tij).

Përveç kësaj çdo fëmijë është një ndër shumë të tjerë dhe përgjigjet për rregulla që janë të njëjta për të gjithë, pra jeton përvojën e futjes në një realitet që merr ngjyrim të veçanta.

Së fundi ndodh takimi me një të rritur të ri që bëhet për fëmijën një pikë referimi e rëndësishme: krijohen procese

identifikimi ndaj mësuesit dhe kjo është e mundur pasi në këtë moshë duhet të ketë zgjidhur një sërë problemesh në lidhje me marrëdhëniet afektive me prindërit (problematika edipike).

Pra është hapësira dhe qetësia për t'iu drejtuar një marrëdhënieje afektive dhe përcaktuese me të rriturin.

Dora-dorës shokët nisin të kenë rëndësi gjithnjë e më të madhe sepse grupi është edhe një mundësi eksperimentimi, rivlerësimi dhe afirmimi të vetvetes; por kjo është e mundur vetëm nëse fëmijët fillojnë të rregullojnë të qëndruarit e tyre së bashku.

Shfaqen rregullat për të luajtur me të tjerët, që kufizojnë dëshirën e secilit por vetëm pjesërisht, edhe sepse këmbëhen rolet. Grupet janë pak të qëndrueshëm, grinden shumë. Sidoqoftë është interesi dhe dëshira për të qëndruar me të tjerët sepse kështu fëmija eksperimenton.

Disa vëzhgime në lidhje me rrafshin njohës

Nga pikëpamja njohëse kemi lënien pas të karakteristikave të mendimit fëmijëror që kanë shënuar botën afektive dhe marrëdhënore të fëmijës (egocentrizëm, realizëm, animizëm).

Mendimi bëhet i pakthyeshëm; kjo do të thotë të mbash parasysh dy gjëra njëkohësisht (për shembull, mund të mbajë parasysh rrokjen e parë ndërsa lexon të dytën, mund të përftojë konceptin e kohëzgjatjes, të radhës).

Fëmija është pra në gjendje të kryejë veprime logjike mbi realitetin, por gjithmonë kur ka të dhëna reale (zbritjet mësohen më mirë me gështenjat);

Ndërkohë që ende nuk është në gjendje të zgjidhë një problem abstrakt, pa i pasur përpara të dhënat (mendimi veprues-konkret).

Ende nuk ka aftësinë e një arsyetimi hipotetik, nuk ekziston tek fëmija i kësaj moshe koncepti i mundësisë në vetvete.

Drejt adoleshencës

Pyetjet kryesore për ekzistencën: kush jam unë, nga vij, cili është fati im, kthehen me forcë dhe më seriozisht. I rrituri e shoqëron fëmijën ndërsa përballon me guxim dhe vërtetësi këto pyetje që lindin që në fillim të ekzistencës, por që ngrihen vendosmërisht në këtë periudhë të jetës.

Në vitet e paraadoleshencës “grupi i të barabartëve” bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, deri sa përbën për adoleshentin një vend “mbrojtjeje” dhe “mbështetjeje” në udhën e gjatë të shkëputjes nga mënyrat fëmijërore të të jetuarit të marrëdhënieve, pra në radhë të parë nga shkrirja dhe nga varësia.

Por fillimisht, vetë marrëdhënia me grupin jetohe me mënyrën, e analizuar më lart, të “varësisë së dytëshme”. Kështu adoleshenti shfaq paqëndrueshmëri të lartë ndaj “miqësive”, “zgjedhjeve” ose “grupeve”, prandaj më shumë se një herë do kalojë nga një përcaktim-shkrirje totale me personat, veprimtaritë ose grupet, në një braktisje të papritur të këtij përcaktimi, me një mosvazhdimësi të habitshme të përvojave.

Pra adoleshenti nuk arrin shpesh t'i mbajë të bashkuar e të ndarë unin dhe ti-në, në mënyrë që të formohet “ne”, si me të rriturit ashtu dhe me bashkëmoshatarët.

Është e vështirë të dilet nga adoleshenca, jo vetëm për adoleshentët por edhe për të rriturit që janë të lidhur me ta, para së gjithash prindërit dhe edukatorët. Nëse është e vështirë të dilet nga shtëpia në kuptimin e lënies së guaskës që të mbron, është në fakt po kaq e vështirë të shkëputesh nga fëmijët apo nga ai që e jeton si bir/bijë.

Kështu, kapërcimi i kësaj faze kritike të marrëdhënies është një proces që përfshin adoleshentin dhe prindërit e tij dhe, në njëfarë mënyre, edukatorët.

Pra zhvillimi nuk është diçka e përshkallëzuar, e sigurt dhe progresive; rritja e moshës dhe rrjedha e kohës nuk përkojnë me një progres automatik.

Rritja është një proces në thelb dinamik dhe të fituarit e cilësisë së mirë në disa marrëdhënie nuk të mbron nga dështime në marrëdhënie të tjera, apo nga përkeqësimi i mëvonshëm i marrëdhënieve që fillimisht janë të mira.

Mundësitë për marrëdhënie të një fëmije zhvillohen në fakt nëse qeniet e tjera njerëzore gjejnë në to në mënyrën e duhur: zhvillimi shoqëror i një individi lidhet me llojin e familjes në të cilën ai lind, me llojin e personave që ai takon më pas dhe me cilësinë e ndërveprimit që përcakton me to. Në fund të kësaj udhe duket qartë se karakteristika themelore e personit është ndryshimi. Rritje do të thotë ndryshim, shndërrim.

Vendet (duke pasur parasysh marrëdhënien me vendin) brenda të cilit jeton personi (familja, shkolla...), duhet të jenë në gjendje të sjellin këtë ndryshim.

Nëse “vendi” ku personi banon (pra ajo marrëdhënie e veçantë në familje, në shkollë), nuk është në gjendje të sjellë ndryshimet dhe të zgjerohet në bazë të tyre, atëherë është një vend i destinuar të mos banohet më, një vend ku të banuarit bëhet i ngushtë, i bezdisshëm, jo i rehatshëm.

Marrëdhënia me fëmijën nuk është kurrë statike. Si i rritur unë e “mikpres”, e “mbaj/e sjell”; ai rritet, ndryshon, dhe unë, në kohë, e bëj këtë marrëdhënie të aftë të sjellë rritjen e tij.

Në thelb rritemi bashkë.

Në fakt, ajo çka bashkon një prind me fëmijën e vet është pikërisht të qenit në pozicionin e “birit”; sepse, ndërsa udhëheq, mësoj gjithmonë diçka për veten, mbi tjetrin, mbi realitetin.

Por, e dimë, di të udhëheqë ai që di të ndjekë.

NJË VËSHTRIM MBI ADOLESHENCËN

Termi adoleshencë vjen nga latinishtja dhe do të thotë “të rritesh” dhe përkufizon atë fazë të zhvillimit njerëzor në të cilën kalon nga të qenit fëmijë në të qenit i rritur. Ajo ndikohet fort nga kushtet socio-kulturore sipas të cilave kohëzgjatja ka pësuar ndryshime të ndjeshme. Më kujtohet që në disa kultura “primitive” kjo periudhë nuk theksohej, por ekzistonin disa “rite nismimi” që një fëmijë të kalojë në detyrat e një të rrituri, duke kaluar disa prova force dhe/ose shkathhtësie. Edhe në perëndim, në klasat punëtore, deri në ardhjen e legjislacionit të punës në fillim të Nëntëqindës, fillimi i punës përkonte me fundin e fëmijërisë, fëmija në ofiçina, në fusha dhe në miniera kish një ritëm dhe detyra prej të rrituri. Sot ajo përfshin edhe vite që deri një brez më parë, konsideroheshin pjesë e moshës së rritur.

Adoleshenca siç e njohim sot, është studiuar dhe “evidencuar” për disa faktorë:

- zgjatja e kohëzgjatjes së jetës;
- progresi teknik, me nevojën për një formim të zgjatur në kohë dhe zgjatja e kohës së shkollimit;
- përmirësimi i kushteve të jetës.

Shpesh priremi të flasim për të si për një periudhë krize, duke vënë në dukje vetëm problemet e saj. Adoleshenti shihet për atë që nuk është më – një fëmijë – dhe për atë që ende nuk është – një i rritur. Ndërkohë që ai duhet parë si brenda një faze zhvillimi specifike që karakterizohet nga kërkimi i identitetit të vet.

Për këtë arsye, një lexim i saktë i nevojave dhe i pritshmërive të adoleshentëve, duhet të mbajë parasysh:

- aftësitë e tyre,
- njohuritë e tyre,
- mundësitë e tyre.

Duke u nisur nga impostimi i sjellë nga Erikson për zhvillimin e renditur si “cikël jete” – edhe më interesante është të nisesh nga një kontekst psikosocial, që mban parasysh jo vetëm aspektet psikike dhe seksuale (si për Frojddin), por edhe ato shoqërore dhe kulturore – vërejmë se ai ndalet jo vetëm tek e tashmja e personit, por edhe tek e shkuara dhe e ardhmja e tij.

Identiteti shfaqet si funksioni që bashkon qenien njerëzore, dhe për këtë arsye është veçanërisht i dobishëm për të kuptuar periudhën e adoleshencës.

Vështirësia që adoleshenti duhet të përballojë lidhet me antitezën mes identitetit dhe konfuzionit të identitetit, dhe kjo mund ta bëjë të mbërrijë forcën psikosociale të besnikërisë, pra aftësinë për të qenë koherent dhe të ndershëm kundrejt një angazhimi të marrë përsipër si kundrejt vetes ashtu dhe kundrejt të tjerëve. Adoleshenti i kërkohet të mohojë identifikimet e fëmijërisë, duke kërkuar një mënyrë të ndryshme dhe vetjake për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët, por duhet të zgjedhë një perspektivë zhvillimi duke hequr dorë nga të tjera, që i ndien sidoqoftë të kënaqshme. Edhe me prindërit jeton momente “refuzimi” (apo mospranimi) dhe momente dëshire për “t’u riafruar”.

Kjo punë për ndërtimin e identitetit (unë kush jam, një burrë, një grua, çfarë do bëj kur të rritem...) edhe nëse përfundon me sukses, nuk përfundon me daljen nga adoleshenca por do të vazhdojë të jetë një element thelbësor i jetës së personit, në fazat e mëtejshme të zhvillimit.

Zhvillimi fiziko-trupor dhe seksual

Është një ndër aspektet kryesore që e përfshijnë adoleshentin, sidomos në fazën e para-adoleshencës. Duhet mbajtur parasysh një lloj paraprirjeje të këtyre dukurive disa dekada më parë, për sa u takon menstruacioneve të para dhe rritjes së peshës dhe të lartësisë, shënjuar nga kushtet më të mira socio-ekonomik dhe shëndetësore të jetës.

Ndryshimet biologjike shënojnë hyrjen në pubertet, por këto ndryshime, sado të pritshme, e befasonë adoleshentin që duhet të përballojë një proces të ndryshimit të imazhit trupor të vetes, duke u gjendur në një trup “të ri”. Ka një disekuilibër mes pjekjes trupore të fituar apo në përftim e sipër dhe një aftësie ende të papjekur psikike. Ndonjëherë ka adoleshentë të zhvilluar fizikisht por ende “fëmijë” si perceptim i vetes, dhe të tjerë më të pjekur në aspektin psikik por ende pak të zhvilluar nga pikëpamja fizike; dhe kjo mund të krijojë konflikte edhe në marrëdhëniet mes të bashkëmoshatarëve.

Ndryshimet fizike kryesore mund të përcaktohen kështu:

- **zhvillim në nivel sistemesh:**
 - o i përgjithshëm (skelet, muskulaturë..),
 - o nervor,
 - o limfatikë,
 - o gjenitalë (testikul, prostatë, vezore).
- zhvillimi i skeletit dhe i muskujve, jo në mënyrë të njëtrajtshme në gjithë sektorët e trupit.
- treguesi trupor, lartësi dhe peshë, që si ndryshimet e tjera “të dukshme” mund të gjenerojë përkohësisht mospërputhje, burime shqetësimesh të pashmangshme. Në fakt, mënyra e të ecurit mund të duket qesharake, e ngathët, gjestet të pakoordinuara.
- ka një tjetër dallim në kohët e ndryshimit, që ka të bëjë me gjininë: tek vajzat fillon më parë, që në moshën 10-13 vjeç, tek djemtë një apo dy vjet më vonë.
- gjithë kësaj i shtohet një dallim jo i pakët ndërindividual.

Në këtë periudhë të karakterizuar nga ndryshimi kanë rëndësi të madhe edhe ndryshimet që prekin sferën e seksualitetit, që fiton për disa aspekte një rol kryesor.

Zhvillohen tiparet seksuale dytësore, gjoksi dhe qimet e organeve gjenitale, vjen menstruacioni i parë dhe ereksioni i

parë.

Rishfaqen në jetën e adoleshentit ngacmimet seksuale (të pranishme në vitet e para të jetës dhe që janë ngadalësuar në periudhën e latencës) si rrjedhojë si e pjekjes aktuale fiziologjike ashtu dhe e afrimit gjithnjë e më të shpeshtë ndaj grupit të bashkëmoshatarëve. Rritet vëmendja për seksin tjetër; në takime mund të kenë një sjellje që priret të tërheqë vëmendjen. Mund të shfaqen dukuri autoerotizmi – masturbim – ndonjëherë të lidhura me ndjenja faji, që mund të ndikojnë në vetëvlërësimin e adoleshentit.

Ndryshimet fizike e puberale kërkojnë një punë përkufizuese të unit të vet si burrë apo si grua; ndikojnë në të familja, shkolla dhe bashkëmoshatarët.

Të jesh mashkull apo të jesh femër do të thotë sot të përballësh me një realitet më kompleks, kundrejt modeleve më të vendosura se disa kohë më parë.

Ndikime psikologjike të ndryshimeve fizike dhe të pjekjes seksuale

Reagimet subjektive ndaj ndryshimeve lidhen me faktorë ndërpersonalë (historia e vet dhe përvoja e mëparshme) dhe shfaqja tek adoleshenti e frikës që ndryshimet do ta bëjnë më të dëshirueshëm në sytë e të tjerëve. Ndonëse nuk flet për frikërat e veta lidhur me defekte dhe parregullsi që ai sheh në trupin e tij, adoleshenti mendon që të tjerët e kuptojnë këtë, sikur të ishin një “pasqyrë shtrembëruese” që tregojnë një pasqyrim të vetvetes të paplotë e të huaj.

Një tjetër faktor lidhet me shfaqjen e dallimeve ndërindividuale. Ka veçanërisht rëndësi koha e ndryshimit dhe kohëzgjatja e tranzicionit, sepse të piqesh më parë apo më vonë se të tjerët nuk është se s’ka rëndësi dhe sjell pyetje të llojit: do të jem apo jo normal?

Mund të dallojmë në këtë një element “kulturor”; mesazhet që përfshijnë adoleshentët përmes masmediave ofrojnë në fakt një imazh të trupit si vend që duhet të pasqyrojë

identitetin e personit (vlera, përkatësi...) që shndërrohet pas mangangshmërisht në një element krahasues në fazë zhvillimi. Në këtë kontekst mund të shfaqen raste të ndryshimit të përkohshëm e përhershëm të trupit të tyre, si pirsing dhe tatuazhe. Po në këtë kontekst mund të vëmë në dukje origjinën e patologjive si anoreksia ose bulimia, që bëjnë pjesë në kategorinë e shqetësimeve ushqimore, tregues të “mungesës së afektit” në vetvete, e pra të të tjerëve.

Në dritën e sa më sipër mund të flitet për trupin si për një zonë plot me mundësi dhe perspektiva që, për këtë arsye, duhet të trajtohet së bashku me dimensione të tjera (kulturore, shoqërore, njohëse, afektive), me një shikim të tërthortë që mban parasysh të gjitha aspektet e personit.

Inteligjenca

Inteligjenca është aftësia racionale, specifike e qenies njerëzore, për “të lexuar brenda realitetit”, pra për t’iu hapur kërkimit të kuptimit dhe të “pasionit” për gjithë sa ekziston.

Është një dukuri që ka të bëjë me tërë personin, në aspektet e tij njohëse por edhe afektive, motivues, dhe të vlerës.

Mendimi njerëzor pjek gjatë kësaj periudhe strukturat e veta të qëndrueshme, përgjithësisht brenda moshës 15-16 vjeç; vetëm tani mund të flitet për “mendim formal me karakter hipotetik – deduktues, bazuar tek kthyeshmëria” (J.Piaget). Adoleshenti është i prirur jo më vetëm ndaj veprimit, por ndaj reflektimit. Mënyra e tij e të menduarit nuk lidhet më me konkretin e menjëhershme, por arrin të krijojë marrëdhënie gjithnjë e më komplekse mes të dhënave të ndryshme reale dhe mendore, duke u nisur nga supozime të mendjes.

Nuk është vetëm logjika ajo që zhvillohet në këtë periudhë; në fakt asistojmë në lindjen e mendimit formal, pra të mendimit që i lë më shumë hapësirë “të mundshmes” madje, për disa aspekte të paktën, qendërsia e ‘të mundshmes’

zëvendëson qendërsinë e ‘realitetit’ që kish epërsi deri në atë çast për subjektin. Në të vërtetë, e mundshmja ishte parë deri në atë kohë nga fëmija si një zgjatim i reales, shumë afër - e prandaj zakoni për të parë një lloj vazhdimësie bënte që të mendohej si e mundshme – me adoleshencën është e mundshmja që përfytyrohet si ekzistuese ndërsa realja bëhet vetëm një pjesë e kësaj mundësie.

Këto struktura formale të mendimit janë rezultati si i pjekjes cerebrale ashtu dhe i marrëdhënieve shoqërore që mund ta ndihmojnë apo frenojnë atë. Por sidoqoftë duhet mbajtur parasysh se në këtë fazë të pjekjes mbërrihet veç pasi të jenë konsoliduar mirë fazat e mëparshme dhe që një fëmijë vazhdon të jetë i angazhuar, dhe shpesh i angazhuar fort, me fazat fillestare të mëparshme të pjekjes së inteligjencës.

Është pikërisht hapja ndaj të mundshmes, hipotetikes që i jep mundësi adoleshentit të afirmojë dhe “mbështesë” ideale të reja, si politike ashtu dhe etike e shoqërore, që në përgjithësi shndërrohen në mundësi për t’iu kundërvënë zgjedhjeve prej të rrituri, që i ndien të detyruara. Është e qartë që në këtë fazë nuk është ende i pranishëm verifikimi i përvojës personale, ajo që hera-herës ishte në vitet e mëvonshme, përjetuar si diçka ku idealet i lënë vend realitetit, e që përkundrazi s’do jetë tjetër veç njohja e një ‘parimi të realitetit’ që vihet kaq shumë në diskutim, në adoleshencë, nga parimi i mundësisë. Sigurisht, këshillat e të rriturve, ndonëse ndonjëherë pranohen, nuk do mund të zëvendësojnë bërjen e përvojës që i kërkohet adoleshentit nga vetë nevoja për zhvillim që, fillimisht, e bën të emfazojë parimin e mundësisë.

Në këtë perspektivë kuptohet përse adoleshencia shfaqet si një periudhë në të cilën fëmija ndihet i pezullt mes familjes (parimi i realitetit) dhe botës së jashtme (parimi i mundësisë), duke ndier kufizim dhe perspektiva të njëjës e tjetrës gjendje, por duke mos gjetur ende një ekuilibër.

Zhvillimi i aftësive të reja mendore ndikon mbi “grykimin moral”. Ka një kalim nga një moral heteronom, bazuar në

autoritetin e të rriturit, në një moral autonom, për të cilën jemi përgjegjës. Ky kalim ndihmohet nga përballja mes të bashkëmoshatarëve që sjell të kuptuarit dhe të pranuarit kritik të rregullave dhe lidhet me përgjegjësinë subjektive të veprimeve.

Struktura njohëse ka tre aspekte, asnjëri prej të cilëve nuk mund të harrohet:

- manipulimi;
- organizimi perceptues dhe përfytyrimi;
- aparati simbolik.

Këto aftësi intelektuale, duke qenë të përfuara, e ndihmojnë adoleshentin të:

- bëjë teori (çfarëdojloj projekti dhe ideje që udhëheq veprimin)
- mendojë për të ardhmen, futjen e tij në botën e punës, në rolin shoqëror, etj.

Këto mundësi të reja intelektuale shpjegojnë edhe shfaqjen e mundshme të një mekanizmi, të “intelektualizimit”, armë mbrojtjeje kundër vërshimit të instinktit dhe/ose justifikim për ikjen në rast rrethanash zhgënjyese.

Strukturat e reja përdoren ende në mënyrë “egocentrike”; adoleshenti prirët të fantazojë, është sikur të kish një makinë por ende pa benzinë (pra përvoja me të cilën mund ta përdorë atë).

Aspekte socio-kulturore

Marrëdhënia me të tjerët, marrëdhënia ndërpersonale janë aspekte thelbësore të njeriut që nga lindja; tek marrëdhënia e nënës me ti-në “lind” uni tek fëmija.

Në adoleshencë dimensionin e racionalitetit zgjerohet dhe aspektet socio-kulturore që karakterizojnë ndryshimin janë para së gjithash kufizime dhe detyra, vlera pozitive dhe negative të grupit dhe të miqve.

Adoleshenti kërkon përgjithësisht të “qëndrojë” në grup.

Ashtu si afirmimi i vetvetes mund të jetohet “kundër” prindërve, ashtu dhe të afruarit ndaj një grupi është një mënyrë “për t’u dalluar” dhe “për t’u kundërvënë” ndaj të rriturve (shumë i ndryshëm nga grupet e fëmijëve të një moshe më të vogël, ku kryeson aspekti i lojës dhe i të vepruarit).

Koha dhe hapësira në grup përjetohen në mënyrë specifike si të ishin në një dimension fantastik, shpesh në një lëvizje të vazhduar, për të mos menduar, gati një ikje nga realiteti i vet i perceptuar si kufizim.

Grupi, në adoleshencë, ka detyra të rëndësishme, pasi përbën strukturën mbështetëse për ndryshimet e trupit, të imazhit të vetvetes dhe perceptimit të realitetit të jashtëm. Të menaxhosh ndryshimin është thelbësore për vazhdimësinë e vetvetes; duhet që dikush të na shohë dhe të na njohë për atë që jemi dhe që po bëhemi. Në fëmijëri këta dëshmitarë të privilegjuar janë prindërit; por ata nuk janë më të mjaftueshëm për adoleshentin: nga grupi i moshatarëve të vet ai pret t’i vërtetohet një normalitet, njohjen e vetvetes me karakteristikat e identitetit që janë të tijat (apo që adoleshenti mendon se duhet të jenë të vetat).

Grupi sjell të jetuarit e plotë, të bashkuar e të vazhduar për faktin që këto ndjenja që dikush i provon për herë të parë “provohen” edhe nga të tjerë. Është burim rivlerësimi dhe përforsimi për narcizizmin: “kam një grup të mirë, gjendem mirë”. Plotëson nevojën për t’u shkrirë (si një përdorim i caktuar i muzikës, si të pish me të tjerë, etj.), për të përballuar momente depresive për ndarjen nga trupi fëmijëror – nga prindërit e idealizuar në fëmijëri – nga identiteti i vet fëmijëror.

Grupi mund të përcjellë ndjesi fuqie dhe të ofrojë doza vetëvlerësimi, që u shërbejnë ndryshimeve të mëdha. Grupi i jetuar në këtë mënyrë “ndihet” shumë në adoleshencën e parë, sidomos ndër djemtë; ata mund të thejnë apo shkatërrojnë, por mund të jetë edhe mundësia për të kanalizuar shumë energji, nëse iu ofrohet e propozohet atyre – asnjëherë të

detyrohen – një përmbajtje shprehëse, një mënyrë të sjelli dhe angazhimi më konstruktiv nga pikëpamja shoqërore.

I rrituri ruan një detyrë, jo atë të “shokut me çdo kusht”, mjafton që ai të jetojë personalisht një përvojë pozitive, një përkatësi dhe një domethënie për jetën e vet, duke treguar dhe shoqëruar me kujdes, i tëhequr rrugën drejt të qenit i pavarur.

Për sa u takon miqësive duhet pasur parasysh sa mund të jenë të veçanta; për shembull është e njohur dukuria e shoqes së ngushtë, për vajzën pasqyrë e asaj çka ajo jeton, si kërkim i shkrirjes, ndonëse mund të ketë frikë se mund të braktiset.

Duhet pasur gjithashtu parasysh ndikimi i modave dhe për rrjedhojë, i pushtetit që mjetet e komunikimit të masës kanë mbi adoleshentët, duke futur një imazh të rremë të lirisë, duke kushtëzuar sjelljet që fitojnë tipare “kolektiviste”, shpesh janë fytyra tjetër e vështirësisë së adoleshentit për të njohur vetveten dhe për t’u pranuar, pra zanafilla e një vetmie personale dhe/ose mërzie të përgjithshme.

Nëse shohim gjithë zhvillimin si një kalim progresiv dhe të përsëritur nga shkrirja tek dialogu, kjo periudhë, ndonëse e mundimshme dhe lodhshme, përfaqëson për adoleshentin mundësinë për të zbuluar identitetin e vet dhe për të vërtetuar një përkatësi plot me domethënie ekzistenciale.

Ndërsa prania e të rriturit, në dukje shpesh e refuzuar, përfaqëson një burim të domosdoshëm për adoleshentin. Si të rritur në fakt mund të jemi dëshmitarë që çdo person ka një fat të mirë, ku adoleshenca është pjesë e një rrugëtimi më të madh.

Në këtë dritë është e rëndësishme që ndër të rriturit, familjet dhe edukatorët, të jetë e pranishme (por të jetë edhe e perceptueshme nga adoleshenti) një miqësi e vërtetë dhe gatishmëria për të ndihmuar, jo për t’u mbrojtur nga trysia e madhe psikologjike që ka edukatori nga kalimi i adoleshencës, por për të mos qenë pre e një mendësie shpesh të paqartë dhe pa përmbaje ekzistenciale të vlefshme dhe për

të mos reshturi së qeni të gatshëm në marrëdhënien me të edukuarin.

Fazat e një qasjeje

Të dalësh nga fëmijëria – të mësosh të duash, t’i hapesh botës, të gesh vendin tënd në jetën shoqërore: kështu mund të përmblihet rruga që duhet të përshkojë çdo adoleshent. Të dalësh nga fëmijëria. Çdo adoleshent trazohet nga ajo që i ndodh, si të jetë pre e një uragani, trupi i tij është pre shqetësimesh dhe ankthesh: një ditë dëshiron të jetë edhe një herë “i vogli i mamit”, dhe ditën tjetër do të jetë “si një i rritur”. Fazat themelore të daljes nga fëmijëria dhe hyrjes në botën e të rriturve mund të ndahen në këtë mënyrë.

- të heqësh dorë së qeni një fëmijë dhe të bëhesh dikush mes të rriturve. Të mësosh të duash: djemtë dhe vajzat hyjnë në fazën gjentiale dhe njëkohësisht bëhen kureshtarë për njëri-tjetrin. E kërkojnë njëri-tjetrin, gjenden. Ndihen të aftë për një takim heteroseksual dhe njëkohësisht ndiejnë nevojën e brendshme për ta shtyrë takimin që, për të qenë i frytshëm, duhet që në fillim unë të gjej vetveten.
- t’i hapesh botës: kush je, cili është portreti yt, kë kërkon. Puberteti është një periudhë e jetës që gëlon nga përfytyrimi. Periudhë fantastike, e pasur me zbulime të brendshme, ku lindin sekrete intime për t’u fshehur në fund të vetvetes por që duhet të gjejnë në njëfarë mënyre një bashkëbisedues për të qenë të bashkëndara, kusht që konsiderohet i nevojshëm për të kuptuarit. Ai shfaqet gjithmonë si bartës i dy rezultateve të kundërta të mundshme: tërheqja në vetvete; hapja ndaj botës.
- të gesh një vend në jetën shoqërore. Ndërsa fëmija gjen grupin e tij referues të parapëlqyer tek familja, i riu adoleshent ku (i kujt) është? Të dalësh nga vetvetja për t’iu hapur botës. Ndjënjë e shumë prej tyre

është se në këtë periudhë të jetës janë pjesë e askujt. Të rritur e adoleshentë të rinj duket se i përkasin dy botëve të ndryshme, madje botëve të ndara.

- të gjejë (ende) një vend të vetin në familje. Ky objektivi, më shumë se të tjerët që përmendëm më lart, mund të arrihet vetëm me mbështetjen e vetëdijshme të të rriturit edukator (jo vetëm prind). Nëse kjo detyrë nuk bashkëndahet kalimi në jetën e rritur do të shënjohej nga një thyerje që do të shoqërojë gjithë jetën e ardhshme të adoleshentit. Për këtë arsye, mirëkuptimi dhe bashkëndarja janë takimet që edukatori s' duhet të humbë.

Si të gjitha fazat, edhe dalja nga fëmijëria shënjohej nga hapa që ndjekin njëri-tjetrin. Nuk jam më fëmijë: puberteti është një çast i rëndësishëm ku një fëmijë vdes dhe një i rritur i vogël kërkon të lindë. Një lëvizje e shkëmbyer mes vdekjes dhe jetës.

Një fëmijë vdes. Fëmija që vdes në pubertet është fëmija i urtë i periudhës së latencës, nxënësi që studion, motra që merret me vëllain e vogël, etj. Do e dëgjoni të thotë: “po, në fund të fundit s'jam më një fëmijë”. Mund të mos pranojë më ta thërrasin me shkurtime të mëparshme, përkujdesjet që tregonin më parë për të, gjeste ‘të buta’ që më parë ishin mundësi për momente kënaqësie, etj.

Pasiguria e madhe e brendshme krijon një siguri të jashtme, vazhdimisht agresive dhe jo e gatshme të lëshojë pe.

I vogli kthehet. Kjo përmbysje shkaktohet nga kthimi i fëmijës së vogël prej 3-5 vjeç: besohej se kish vdekur, por vetëm po flinte!

Rizgohet në familje: shpërthim inati, nuk pranon të hajë apo të flejë, rivalitet apo përjashtim i një prej dy prindërve, ankth sepse mohohet në trupin e tij dhe në ndjeshmërinë e tij narciziste.

Puberteti është një rizgjim i krizës së madhe edipike, me gjithë sa kjo shfaq për dashuri e urrejtje, butësi dhe agresiv-

itet, kërkim sukcesi dhe fitore të lirisë.

Dallimi është se kompleksi i Edipit organizohet tashmë rreth gjenialitetit të djalit/vajzës që po përpiqet të bëhet një burrë apo një grua.

Një i rritur i vogël lind. Në kohë të tjera, kur fëmija bëhej pubere, ish futur solemnisht në shoqërinë e të rriturve. Adoleshenca nuk ishte një periudhë e parë në hollësi në jetën psikike dhe shoqërore. Adoleshenti i sotëm ka të njëjtën dëshirë për të hyrë në jetën e rritur; përpiqet të bëhet pjesë e bisedave të të rriturve, kërkon një jetë afektive dhe seksuale, do donte të kish përgjegjësi dhe pushtet. Vuajtja vjen nga fakti që nuk gjen (nuk njuh) një vend të përshtatshëm për të rriturin e vogël që është duke lindur.

Ky trup, trupi im. Mes moshës 11 e 15 vjeç djemtë/vajzat kërkojnë të zotërojnë trupin e tyre:

- përmes rritjes fizike. Trupi shndërrohet pavarësisht “nga unë”, humb përpjesëtimet harmonike.
- përmes seksualitetit të rizgjuar (praktika masturbimi, prirje të mundshme homoseksuale, dëshira heteroseksuale). Masturbimi në këtë moshë në fillim është një mënyrë për të eksploruar trupin (çlirim fizik i ngacmimeve, verifikim i identitetit të djalit/vajzës, fillim imagjinar i një takimi seksual, më i rëndësishëm dhe konstruktiv si moment kalimi). Edhe miqësitë e veçanta janë kërkimi për të qenë të sigurt për vlerën e seksit të vet, duke u identifikuar me një tjetër të të njëjtit seks.

Është e rëndësishme që prindërit të mos druajnë atë që s' do ish normale, por të nxisinin zhvillimin fiziologjik drejt seksit tjetër, pa dramatizuar e as banalizuar “punën” e të bërit burrë apo grua.

Kush jam unë? Kjo është tema mbizotëruese, përmbledhëse, që bashkon përvojën e larmishme kritike të adoleshencës. Në përpjekjen për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje themelore, përgjigja e së cilës duket përcaktuese për të ardhmen e tij, adoleshenti shihet në tri pasqyra: e veta, ajo e shokëve dhe

pasqyra e të rriturve.

- e veta: imazhi nuk duket kurrë ashtu siç pritet të jetë. Paraadoleshenti nuk e pranon pozitivisht veten. Në përpjekjen për t'u ri-gjetur në çdo detaj humb ndjenjën e unitetit të vet dhe kohezionit të brendshëm. Fryma trupore-seksuale dhe emocionale është kaq e fortë sa që nuk di më çfarë po i ndodh fytyrës dhe imazhit të tij (si në mitin e Narcizit). Përpiqet ta kapë imazhin e tij e ta identifikojë me të vetin. I pëlqejnë pasqyrat; shumë poza përpara pasqyrave kryejnë të njëjtin funksion psikik: në funksion të unifikimit të përkohshëm të vetvetes.
- ajo e shokëve: kundrejt normalitetit të trupit të tyre dhe seksit të tyre; mund të trazohen nga frika e të qenit jo normal. Pra është e pashmangshme që çdokush të kërkojë, në shikimin e bashkëmohatarëve të tjerë, efektin që shkakton tek ta. Matet, imiton, ndonjëherë bëhet qesharak. Kjo lojë pasqyrash i drejtohet trupit dhe seksit (sheh 'si merren masat'). Përmes gjithë këtyre identifikimeve të tërheqjes dhe mospranimit ndërtohet personaliteti në nivel imazhi të vetvetes.
- ajo e të rriturve: paraadoleshenti ka shumë nevojë të konfirmohet në imazhin e mirë të vetvetes nga të rriturit, edhe nga prindërit. Ai kërkon me çdo mënyrë këtë konfirmim, heton shikimet, përgjon reagimet, pret një fjalë. Nëse këto shikime janë zakonisht një mjet qortimi apo indiference mund t'i japin udhë një procesi të brendshëm vetëpërcmimi; nëse janë inkurajues mund të vënë në lëvizje një proces të brendshëm rivlerësimi të vetvetes.

Asnjëra nga këto tri pasqyra nuk duhet "thyer": të tria janë të brishta, por që të tria janë të nevojshme.

Shkolla përfaqëson një takim të fundit themelor për kalimin. Paraadoleshenti nuk i konsideron më gjërat për si ato janë: bëhet i aftë për abstraksion, logjikë, dialektikë. Është

në gjendje të ndërtojë përfaqësime dhe të kryejë veprime intelektuale përmes të cilave pohon dhe mohon.

Jo gjithnjë këto aftësi të reja përdoren për të nxënëit. Sepse po në këtë periudhë ai karakterizohet nga një gjallëri e madhe afektive dhe nga një ndjeshmëri e skajshme në situatat e përjetuara. Preket në zemër e në trup përpara se të kuptojë dhe prandaj duhet ndihmuar të përpunojë gjuhën afektive që të mund të zbulojë personalisht arsyen, shtysën për të nxënë. Ndonjëherë arrin të pasionohet ndaj një përmbajtjeje, ndërsa ndonjëherë nuk e pranon dhe justifikon mospranimin me 'pamundësinë e tij për të kuptuar' (mos më thuaj që nuk dua sepse në të vërtetë nuk mundem).

Familja, dhe pse e kundërshtuar, mbetet një vend marrëdhëniesh të privileguara: prandaj kërkon të gjejë këtu autonominë e tij përballë të rriturve. Edhe për këtë duhet të mos harrojmë që familja s'mund të përfundojë në vendin e jetës "private", e mbyllur në vetvete, por është gjithmonë vendi i privileguar i një të nxëni shoqëror, i shënjuar nga hapja ndaj të tjerëve, nga respektimi i lidhjeve mes brezave, e aftë të falë, të dhurojë.

Të nxënëit e autonomisë dhe përgjegjësisë nuk mund të ndodhë nëse këto dy dimensione të marrëdhënies personale dhe shoqërore nuk pranohen dhe propozohen së bashku. Njëra ndriçon dhe sqaron tjetrën.

Faza e rritjes që karakterizon adoleshencën nuk sjell nxjerrjen jashtë loje të edukatorit. Rëndësia e rolit dhe e detyrave të të rriturit vjen pikërisht nga problematika që karakterizon këtë fazë të zhvillimit. Të rriturit adoleshent i kërkon ta ndihmojë të kanalizojë energjitë e veta, ta mbështesë në përpjekjen për t'iu hapur realitetit që të mund të shijojë bukurinë e realitetit, duke nisur nga ajo e unit të vet, ta shoqërojë në këtë mënyrë në zbulimin e lirisë. E gjitha kjo do të thotë t'i kërkojë ndihmë të rriturit për të qenë dëshmitar i kuptimit pozitiv të jetës.

